

Më shumë se 5.400 të rinj të moshës 15-29 vjeç nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova*,¹ Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë marrë pjesë në studimin rajonal E Ardhmja e Përbashkët: Perceptimet e të Rinjve mbi Paqen në Ballkanin Perëndimor. Ky raport thekson zërat e të rinjve si dhe perceptimet dhe përvojat e tyre lidhur me paqen dhe kohezionin shoqëror në shoqëritë e tyre dhe në rajonin e gjerë të Ballkanit Perëndimor.

Mesazhet kryesore që dalin nga studimi janë si vijojnë:

- **Të rinjtë janë aktorët kryesorë në ndërtimin e shoqërive paqësore të qëndrueshme** në Ballkanin Perëndimor. Ata ndajnë shumë aspekte të përbashkëta dhe kryesisht shohin njëri-tjetrin me besim dhe kuriozitet, por ndonjëherë me kujdes. Shpresat dhe vlerat e tyre në gjithë rajonin janë shumë të përafërta. Shumica janë të bindur se gjenerata e tyre përfaqëson një forcë pozitive në shoqëri dhe janë optimistë se do të jenë në gjendje të zgjidhin disa nga sfidat e përhershme në rajon.
- **Besimi midis qeverisë dhe shoqërisë** është një aspekt kritik për paqen dhe kohezionin shoqëror. Në tërë rajonin, niveli i kënaqësisë së të rinjve ndaj sistemeve dhe institucioneve qeverisëse është relativisht i ulët, ndërsa niveli i kënaqësisë ndaj shoqërisë civile dhe organizatave rinore është ambivalente, megjithëse, në mënyrë të ngjashme, mbetet i ulët. Nuk befason fakti që niveli më i ulët i kënaqësisë ndër të rinjtë lidhet me mundësitë e punësimit. Kur u pyetën nëse pandemia ka ndikuar negativisht në besimin e tyre te qeveria dhe vendimmarrësit, 58% e të rinjve ndanë këtë mendim. Përmirësimi i raporteve të prishura dhe besimit midis të rinjve dhe vendimmarrësve është një detyrë thelbësore.
- **Hapësira civile** është themeli i çdo shoqërie të hapur, kohezive dhe demokratike. Të rinjtë e pranojnë se kanë rol të rëndësishëm për t'i ndikuar ndryshimet. Megjithatë, vetëm 19,5% e të rinjve në rajon marrin pjesë në aktivitetet civile. Duket se ekziston një potencial i madh për angazhimin civil, duke marrë parasysh se mbi 65% e të rinjve në rajon raportojnë interes për t'u përfshirë më aktivisht. Ndjenja e vetë-efikasitetit dhe kontrollit tek të rinjtë shoqërohet me mendjehapje ndaj grupeve të tjera dhe me më shumë optimizëm për paqen në rajon. Ndaj, hapja e rrugës ndaj angazhimit më të madh të të rinjve dhe ndaj ndjenjës së kontrollit është kritike.
- **Vlerat demokratike dhe të barazisë** tek të rinjtë janë të ndërlidhura në mënyrë të rëndësishme me qëndrimet ndaj kohezionit shoqëror dhe paqes. Përafrimi i të rinjve me vlerat demokratike duket se lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me të qenit të ndërgjegjshëm për ngjashmërinë midis popujve të Ballkanit Perëndimor, si edhe me shpresën për përmirësimin e marrëdhënieve të

1 * Në rast të KB, të gjitha referencat për Kosovën do të kuptohet se janë bërë në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999). Për RYCO-n, ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi Deklarimin e Pavarësisë së Kosovës.

ardhshme në Ballkanin Perëndimor. Për më tepër, në shumicën e vendeve/territoreve, duket se ekziston një korrelacion negativ midis mbështetjes ndaj vlerave autoritare dhe kënaqësisë me qeverinë. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që të kuptojmë se çfarë e nxit mbështetjen e të rinjve ndaj pikëpamjeve autoritare, të adresojmë shkaqet kryesore të këtij fenomeni dhe të përforcojmë një qeverisje transparente dhe gjithëpërfshirëse.

- Kur bie fjala për **kauzat e rëndësishme sociale**, të rinjtë përmendin si zgjedhje të tyre kryesore, ndihmën për të varfërit dhe të marginalizuarit, demokracinë, të drejtat e njeriut dhe ndërtimin e paqes dhe pajtimit - duke treguar një potencial të rëndësishëm dhe të pashfrytëzuar për një angazhim më të gjerë të të rinjve në ndërtimin e paqes dhe përforcimin e kohezionit shoqëror. Ekziston gjithashtu një hendek midis fushave të interesit të të rinjve dhe aktiviteteve, në të cilat me sa duket përfshihen disa prej tyre, duke treguar nevojën për të patur platforma më të shumëllojshme për pjesëmarrjen civile, qofshin këto formale dhe jo formale.
- **Liria nga frika dhe dhuna** qëndrojnë në themel të shoqërive kohezive dhe të begata. Rinia e Ballkanit Perëndimor shpreh disa shqetësime të përbashkëta lidhur me sigurinë. Krimi i organizuar dhe siguria në internet janë ndër shqetësimet kryesore për të rinjtë në shumicën e shoqërive. Të rinjtë e rajonit kanë vlerësuar krimet e urrejtjes si një shqetësim relativisht të lartë, ku vajzat e reja kanë nivelin më të lartë të shqetësimit ndaj krimeve të urrejtjes, sigurisë në internet dhe dhunës në familje, krahasuar me djemtë e rinj.
- **Gjuha e urrejtjes në internet ose jashtë interneti** është forma më e raportuar e dhunës ose diskriminimit, pasi 12% të të rinjve kanë raportuar kështu në gjithë rajonin. Diskriminimi në bazë të moshës, përkatësisë politike ose përkatësisë etnike është raportuar shpesh gjithashtu. Vajzat e reja kanë raportuar diskriminim gjinor dhe ngacmim seksual shumë më shpesh sesa djemtë. Nga personat që kanë përjetuar dhunë ose diskriminim, vetëm 17% ia kanë raportuar dikujt situatën dhe vetëm 58% mendojnë se raportimi mund të sjellë rezultate pozitive. Kjo tregon se ka nevojë për mekanizma ku të rinjtë që të raportojnë përvojat e tyre lidhur me diskriminimin dhe dhunën dhe për institucione dhe autoritete që të adresojnë këto çështje.
- Paqja dhe kohezioni shoqëror përforcohen nga **politikat sociale përfshirëse dhe mbrojtjen e grupeve të marginalizuara dhe të pafavorizuara të shoqërisë**. Diskriminimi etnik, politik ose fetar është një përvojë shumë më e zakonshme për të rinjtë që nuk janë anëtarë të shumicës, sesa për ata që i përkasin shumicës. Të rinjtë me përkatësi etnike jo-shumicë kanë më shumë gjasa të raportojnë se janë viktimat e dhunës fizike ose kërcënimit nga dhuna dhe shumë më pak të ngjarë të marrin pjesë në aktivitete qytetare. Ata shprehin gjithashtu më pak kënaqësi lidhur me institucionet qeverisëse në tërë rajonin.
- Përqindja jashtëzakonisht e lartë e **emigracionit rinor** përfaqëson një problem si për vetë rininë ashtu edhe për shoqëritë që ata i kanë lënë pas vetes dhe është një simptomë e sëmundjeve shoqërore të tjera. Një mesatare prej 52% e të rinjve thonë se ka të ngjarë që pas 10 vitesh do të jetojnë jashtë vendit. Megjithatë, ata shprehin hezitime të qarta lidhur me migracionin: frika nga zhgënjimi dhe trajtimi si qytetarë të dorës së dytë jashtë vendit, si edhe një ngurrim për të lënë

familjen, miqtë dhe një mënyrë të njohur jetese. Megjithëse emigracioni është një fenomen serioz, ai nuk është i pakthyeshëm.

- **Besimi, marrëdhëniet dhe ndërveprimet midis njerëzve**, midis ndarjeve shoqërore, duke përfshirë këtu identitetin dhe konstrukte të tjera shoqërore, janë aspekte të rëndësishme për paqen dhe kohezionin shoqëror. Ndarjet dhe konfliktet e rajonit nuk i kanë lënë të rinjtë plotësisht të paprekur, por shumica e të rinjve tregojnë gatishmëri për të krijuar miqësi me anëtarët e grupeve të ndryshme. Për sa i përket distancës sociale, të rinjtë në Shqipëri dallohen nga moshatarët e tyre, duke shprehur nivele shumë më të ulëta të distancës sociale ndaj grupeve të tjera, të pasuar nga të rinjtë në Bosnjë dhe Hercegovinë, të cilët kanë shprehur distancën sociale më të ulët krahasuar me pesë vendet e tjera. Të rinjtë që kanë miq të ngushtë në grupe të tjera dhe ata që jetojnë në bashkësi multietnike dhe plotësisht të integruara, tregojnë një distancë sociale më të ulët ndaj grupeve të tjera sesa bashkëmoshatarët e tyre. Rreth 47% e të anketuarve në rajon kanë raportuar se ata u besojnë grupeve të tjera pavarësisht nga konfliktet e së shkuarës, ndërsa 24% e të rinjve kanë thënë se nuk u besojnë grupeve të tjera në rajon - këto qëndrime ndryshojnë midis shoqërive të Ballkanit Perëndimor dhe grupeve socio-demografike të ndryshme.
- **Shumica e të rinjve janë optimistë për paqen dhe për marrëdhënie** më të mira në rajon. Ekziston një ndryshim relativisht i vogël midis shoqërive, ndërsa vajzat e reja priren të jenë më optimiste. Edhe në rastin më pesimist, 42% e të anketuarve parashikojnë që marrëdhëniet të përmirësohen. Vetëm 8% parashikojnë që marrëdhëniet rajonale do të përkeqësohen, ndërsa pjesa tjetër nuk parashikon asnjë ndryshim. Kur kemi vlerësuar mundësitë për paqen, kemi gjetur që një kornizë progresive referimi rezonon më mirë me të rinjtë dhe kjo është diçka që duhet të kemi parasysh kur i qasemi temës së trajtimit të së kaluarës.
- Kur u kemi kërkuar që të përmendin deri në tre faktorët më efektivë për paqen dhe stabilitetin, deri në 47% e të rinjve mendojnë se procesi i pranimit në BE **është faktori më i rëndësishëm për krijimin e paqes dhe stabilitetit afatgjatë** në Ballkanin Perëndimor, megjithëse përgjigjet ndryshojnë shumë nga përkatësia etnike. Një demokraci funksionale, promovimi i paqes dhe tolerancës, dialogu midis udhëheqësve dhe prosperiteti ekonomik konsiderohen gjithashtu si faktorë të rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin nga më shumë se 25% e të rinjve në rajon.
- Kontakti ndërgrupor është përdorur shpesh si një mjet për përmirësimin e besimit dhe marrëdhënieve ndërgrupore. E Ardhmja e Përbashkët ka zbuluar se kur bëhet fjalë për marrëdhëniet shoqërore ndërgrupore, **cilësia e marrëdhënieve ndërgrupore** jo vetëm që është më e rëndësishme sesa sasia, por të dyja mund të kenë pasoja të ndryshme. Kontaktet rastësore me anëtarët e komuniteteve të tjera, sidomos në mjedise shoqërore specifike të karakterizuara nga segregimi ose forma të tjera të diskriminimit, mund të jenë kundër-produktive nga kjo pikëpamje dhe në disa raste mund të çojnë në qëndrime negative ndaj të tjerëve. Duhet të shtohen mundësitë që të rinjtë që të takohen dhe të ndërtojnë miqësi përmes të gjithë kufinjve etnikë, fetarë dhe gjeografikë, sepse miqësi të tilla do të çojnë në një gamë të gjerë rezultatesh pozitive.
- Të rinjtë që **fokusohe në të kaluarën** dhe mendojnë se ata dhe shoqëritë e tyre janë ndikuar

negativisht nga konfliktet e së kaluarës, raportojnë një besim më të ulët dhe një perceptim më pak pozitiv ndaj grupeve etnike të tjera në Ballkanin Perëndimor. Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve në rajon, midis 15% deri në 63%, thonë se nuk janë të gatshëm t'i falin të tjerët për veprimet e së kaluarës. Ekziston një nevojë për t'i angazhuar të rinjtë në një dialog konstruktiv mbi të kaluarën dhe efektet e saj në realitetin e tyre të tanishëm.

- **Rrëfimet përçarëse** përfaqësojnë në tërësi, një pengesë të rëndësishme për arritjen e kohezionit social brenda rajonit. Rreth 42% e të rinjve thonë se është e zakonshme të shohësh përmbajtje ofenduese për shoqërinë e tyre në mediat sociale. Midis 49% dhe 75% e vajzave dhe djemve të rinj janë të shqetësuar për lajmet e rreme dhe teoritë konspirative. Ndërkohë që shumica e të rinjve nuk e mbështesnin lirinë e shprehjes, kur kthehet në gjuhë urrejtjeje, një masë e rëndësishme në secilën shoqëri mendon se kjo është një gjë e pranueshme dhe shumë prej tyre e kanë përjetuar.
- Burimet më të rëndësishme të informacionit, nga të cilët të rinjtë **mësojnë për popujt e tjerë në rajon** janë prindërit dhe anëtarët e familjes, miqtë dhe mediat sociale. Shkollat, librat dhe media tradicionale janë gjithashtu burime të rëndësishme informacioni, ndërsa aktivitetet kulturore, projektet rajonale dhe shkëmbimet e të rinjve janë burime shumë më pak të rëndësishme. Megjithatë, midis 61% dhe 91% e të rinjve bien dakord se shkëmbimet e të rinjve mund të kenë një ndikim pozitiv në marrëdhëniet rajonale, duke treguar se kjo është një mundësi për të zhvilluar ndërveprimin midis tyre.
- **Përvojat e udhëtimit** të të rinjve ndërlidhen me ndjenjën e tyre të kontrollit, interesin për angazhimin qytetar dhe distancën shoqërore më të ulët ndaj grupeve të tjera. Të gjithë këta faktorë shoqërohen gjithashtu me një sjellje pro-sociale dhe një pikëpamje më optimiste për paqen. Në përgjithësi, rreth 36% e të rinjve të Ballkanit Perëndimor kanë qenë jashtë rajonit në dy vitet e fundit, ndërsa një mesatare prej 50% të vajzave dhe djemve të rinj kanë udhëtuar brenda Ballkanit Perëndimor. Mungesa e burimeve financiare, pasojat e konflikteve të së kaluarës, preferenca për të udhëtuar diku tjetër dhe paragjykimet ndaj popujve të tjerë të Ballkanit Perëndimor shihen si pengesa për udhëtimet rajonale.

E Ardhmja e Përbashkët: Perceptimet e të Rinjve mbi Paqen në Ballkanin Perëndimor është studim i hartuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), në bashkëpunim me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO). Ky studim është zhvilluar përmes një procesi hulumtues pjesëmarrës të veçantë, i cili ka përfshirë një grup këshillues rinor, që përfaqëson të rinjtë nga tërë rajoni i Ballkanit Perëndimor, dhe ka pasur për qëllim hartimin e një kornize studimi dhe analizën e gjetjeve të saj. Studimi bazohet në të dhëna sasiore dhe cilësore të mbledhura përmes një studimi rajonal dhe diskutimeve të kryera në disa fokus-grupe midis Dhjetorit 2020 dhe Prillit 2021.